

UDHËZIM
Nr. 14, datë 24.5.2013

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë”, bëhet shtesa e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 3.9 “Borxhet e këqija”, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Në rastin e bankave, degëve të bankave të huaja dhe subjekteve financiare jobanka të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies, në kuptim të nenit 24 shkronja “c” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, borxhi i keq mund të fshihet nga librat kontabël:

i) 365 ditë pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm te përmbartuesi gjyqësor, në rast se kredia është e siguruar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme; ose

ii) 365 ditë pas lëshimit nga gjykata të urdhrit të ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e garantuar me pasuri të luajtshme/të paluajtshme.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode